

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7025
E enjte, 19 tetor 2023
Çmimi 0.50 €

Kurti kërkon që forcat shtesë të KFOR-it ta ruajnë kufirin me Serbinë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SHORTI I FATIT, QYTETARËT E KOSOVËS ËNDËRROJNË PËR VIZA PUNE NË GJERMANI



Gjatë vitit 2022 Ambasada e Gjermanisë në Kosovë ka lëshuar mbi 9 300 viza pune për shtetasit e Kosovës. Po gjatë 2022-s Kosova ishte vendi i tretë nga Ballkani Perëndimor me më së shumti

banorë që morën viza pune për në Gjermani. Për emigracion të fëmijëve dhe bashkim familjar, Kosova radhitej e para. Në vitet e fundit mijëra qytetarë të Kosovës kanë marrë viza pune për në

Gjermani. Vetëm vitin e kaluar numri i vizave të punës të lëshuara nga Ambasada e Gjermanisë është rritur për 110 për qind në krahasim me vitin paraprak

AKTUALE



ROTH: IZRAELI KA TË DREJTË TË PËRGJIGJET, POR JO TË BËJË ÇFARË TË DOJË

HAPET PIKËKALIMI KUFITAR NË JARINJË

QEVERIA FILLON PROCEDURAT PËR BLERJEN E OBJEKTEVE TË AMBASADËS SË KOSOVËS NË BERLIN DHE UASHINGTON


EKONOMI



KOSOVA FORCON BASHKËPUNIMIN EKONOMIK DHE TREGTAR ME EMIRATET E BASHKUARA ARABE

FMN-ja: ZGJEDHJA E GUVERNATORIT TË BQK-SË I KA DHËNË SHITYSË TË RE ZBATIMIT TË REFORMAVE FISKALE DHE FINANCIARE NË KOSOVË

SPORT



FC PRISHTINA, FITUESE E SUPERKUPËS KOSOVË - DIASPORË

PEZULLIMI I VIZAVE PËR KOSOVËN S'MUND TË BËHET PA PROCEDURË NË KËSHILLIN E BE-së



KRYEPROKURORI I SHTETIT SHPREH SHOETËSIM PËR NUMRIN E VOGËL TË MBROJTËSVE TË VIKTIMAVE TË KRIMIT



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Roth: Izraeli ka të drejtë të përgjigjet, por jo të bëjë çfarë të dojë

NJU-JORK, 18 TETOR - Si Hamasi ashtu edhe Izraeli janë duke kryer krime lufte në konfliktin aktual, thotë për "Radion Evropa e Lirë" Kenneth Roth, ish-drejtor ekzekutiv i organizatës "Human Rights Watch". Sipas tij, të dyja palët po luftojnë pa respektuar siç duhet parimet e së drejtës ndërkombëtare humanitare. Roth thotë se Izraeli ka të drejtë t'u përgjigjet "mizorive të tmerrshme" të Hamasit, por se kjo "nuk ia jep lirinë të bëjë çfarë të dojë". Ai kritikon rrethimin e Gazës dhe moslejimin e ndihmave humanitare për njerëzit në nevojë, ndërsa i dënon sulmet e të dyja palëve në zonat civile. "Detyra për ta respektuar ligjin ndërkombëtar humanitar, për të mos kryer krime lufte, është

detyrë absolute", thotë Roth, i cili ka shërbyer gati tri dekada në njërin prej organizatave kryesore ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në botë. Në pyetjen se edhe Hamasi edhe Izraeli akuzohen për akte të paligjshme në konfliktin aktual, si i shihni ju sjelljet e tyre deri më tani?, Roth është përgjigjur: "Qartazi, të dyja palët po kryejnë krime lufte. Hamasi ka kryer mizori të tmerrshme, duke vrarë qindra civilë izraelitë dhe duke marrë pengje rreth 200 izraelitë. Këto janë krime lufte, ashtu si edhe sulmet e tij periodike me raketa në zonat e banuara me civilë izraelitë. Qeveria izraelite ka kryer gjithashtu krime lufte, duke qëlluar pa dallim në lagjet palestineze, duke goditur vërtet lagje të tëra në përpjekjet e saj

për t'i ndjekur objektivat e Hamasit. Por, duke qëlluar më gjerësisht, ka sulmuar edhe ndërtesa të mëdha banimi dhe qindra familje kanë humbur shtëpitë e tyre. Izraeli, po ashtu, e ka vendosur [Gazën] nën rrethim, duke ia bllokuar ushqimin, ujin, karburantet dhe energjinë elektrike. Kjo është një formë e ndëshkimit kolektiv të të gjithë popullatës palestineze të Gazës. Pra, qartazi ka krime lufte nga të dyja palët. Është e rëndësishme të theksohet se ligji ndërkombëtar humanitar nuk e shfajëson njërin palë, vetëm se pala tjetër nuk e respekton atë. Detyra për ta respektuar ligjin ndërkombëtar humanitar, për të mos kryer krime lufte, është një detyrë absolute, që nuk kushtëzohet nga sjellja reciproke e



kundërshtarit".

Ai ka theksuar se gjatë luftës mund të hapet zjarr kundër luftëtarëve, por nuk mund të shënjestrohen civilët. "Ju nuk mund të qëlloni pa dallim në zonat civile dhe, madje, nuk mund të shënjestroni as dhe një objektivi ushtarak nëse ndikimi mbi civilët do të jetë

joproporcional. Po ashtu, nuk mund ta bllokoni dërgimin e ndihmave humanitare për njerëzit në nevojë. Pra, këto janë rregullat themelore. Ato janë të përpunuara në shumë detaje, por ky është thelbi i tyre. Dhe, fatkeqësisht, të dyja palët po i injorojnë këto rregulla", ka pohuar Roth.

Shpërthimi shkatërrues në një spital të Gazës, shtetet arabe kërkojnë armëpushim



GAZA, 18 TETOR - Të 22 shtetet arabe në Kombet e Bashkuara janë bërë bashkë për të kërkuar një armëpushim të menjëhershëm në Gazë pas shpërthimit shkatërrues në një spital në qytetin e Gazës.

Riyad Mansour, ambasador palestinez në OKB, tha se anëtarët e Grupit Arab "janë të zemëruar nga kjo masakër" dhe janë të bashkuar në kërkesën për dërgimin e menjëhershëm të ndihmave humanitare dhe

parandalimit "të zhvendosjes me dhunë" të palestinezëve. Mansour tha se pas "masakrës", synimi kryesor është armëpushimi, sepse ai "shpëton jetë dhe është gjëja më e rëndësishme".

Po ashtu, sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Antonio Guterres, tha se është "i tmerruar" nga vdekjet "në spitale dhe personeli mjekësor është i mbrojtur sipas ligjit humanitar ndërkombëtar".

Më 17 tetor në një spital në Gazë ndodhi një shpërthim, që

dyshohet se vrau qindra persona. Izraeli ka mohuar përfshirjen, ndërkaq ka fajësuar grupin militant nga Gaza, Xhihadin Islamik. Por, ky grup, po ashtu, ka mohuar se qëndron prapa shpërthimit.

Qëkur Hamasi kreu sulme të koordinuara më 7 tetor ndaj Izraelit, ky i fundit është kundërpërgjigjur me rrethimin e Gazës dhe me sulme ajrore. Mijëra persona deri më tani janë vrarë si pasojë e dhunës.

PE fton Malin e Zi t'i tejkalojë tensionet politike dhe të përparojë drejt BE-së

BRUKSEL, 18 TETOR - Parlamenti Evropian ftoi Malin e Zi t'i tejkalojë ndasitë politike dhe të përparojë në procesin e integritimeve evropiane, duke theksuar se kriza aktuale politike ia ka humbur një vit të tërë këtij shteti kandidat për Bashkimin Evropian. Kjo është përfshirë në rezolutën për Malin e Zi që u votua më 18 tetor në PE. Ajo u hartua nga raportuesi për Malin e Zi në PE, Tonino Piculla, socialdemokrat nga Kroacia. Gjatë debatit për rezolutën, shumë eurodeputetë shprehën shqetësime për përpjekjet për ndikim nga Rusia në Mal të Zi si dhe përshëndetën vazhdimin e përshtatjes së plotë të Podgoricës me politikën e jashtme dhe të sigurisë së BE-së.

Deputetët në PE kërkuar që cilado qeveri që do të formohet në Mal të Zi ta mbajë kursin drejt BE-së.

Mali i Zi ka mbështetur të gjitha sanksionet e BE-së ndaj Rusisë për shkak të pushtimit të Ukrainës dhe PE-ja kërkoi që kjo të vazhdojë, pavarësisht se në Mal të Zi ka forca politike që kanë qëndrime pro-ruse.

Po ashtu, në rezolutë është përmendur edhe shqetësimi për ndërhyrje nga Kina dhe Serbia në çështjet e brendshme të Malit të Zi.

Deputetët e Parlamentit Evropian përmes këtij raporti kanë kërkuar që Mali i Zi ta përshpejtojë procesin e reformave, sidomos ato që janë të nevojshme për procesin e



integritimeve në BE, siç janë reformat në drejtësi dhe lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Mali i Zi vazhdon të jetë vendi më i avancuar kandidat në procesin e anëtarësimit në BE në

rajonin e Ballkanit Perëndimor. Podgorica ka hapur të gjithë kapitujt negociues në këtë proces dhe deri më tani i ka mbyllur tre kapituj. Por, për vite të tëra nuk ka mbyllur kapituj negociues.

Procesi ka ngecur për shkak të krizave të vazhdueshme politike në shtet.

Mali i Zi ka mbajtur zgjedhje të parakohshme parlamentare më 11 qershor. Lëvizja Evropa Tani fitoi më së shumti vota, përkatësisht 26 për qind.

Qeveria e re pritet të formohet nga Millojko Spajiq. Do të jetë e treta që nga largimi i Partisë Demokratike të Socialistëve të Millo Gjukanoviçit nga pushteti në gusht të vitit 2020. Qeveria e parë e Zdravko Krivokapiqit, e formuar nën ndikimin e Kishës Ortodokse Serbe, zgjati 14 muaj. Qeveria e dytë, në krye me Dritan Abazoviçin, u përball pas tre muajsh me votë mosbesimi dhe deri më sot ajo funksionon me mandat teknik.

Pezullimi i vizave për Kosovën s'mund të bëhet pa procedurë në Këshillin e BE-së

PRISHTINË, 18 TETOR - Disa burime diplomatike brenda Bashkimit Evropian (BE) kanë sqaruar se nuk ka mundësi që një shtet në mënyrë të njëanshme ta pezullojë liberalizimin e vizave për një shtet tjetër dhe se kjo mund të bëhet vetëm përmes një rregulloreje nga Këshilli i BE-së pas një deklarate të presidentit të Francës, Emmanuel Macron, që shkaktoi hutë në Kosovë të martën.

Përderisa për shumë medie në Kosovë Macroni "kërcënoi" me pezullimin e vizave për Kosovën kur tha të martën në Tiranë se "ne kemi bërë një gjest besimi për çështjen e vizave. Sa i përket Francës, ato [vizat] janë hequr sepse ne respektojmë fjalën e dhënë. E sot, fjala nuk po mbahet", por burime brenda bllokut evropian thanë se Franca s'e ka bërë një kërkesë të tillë.

Burime nga Brukseli thanë për "Radion Evropa e Lirë" se pezullimi është i mundshëm vetëm përmes procedurave në Këshillin e BE-së "duke e përdorur

rregulloren për mekanizmin e suspendimit të vizave" nga viti 2018. "Franca, e as ndonjë shtet tjetër anëtar i BE-së, për momentin nuk ka propozuar suspendimin e vizave për Kosovën, apo për Serbinë. Por, nëse do të ketë interes politik, ajo mund edhe ta bëjë këtë", ka thënë një burim i Bashkimit Evropian.

Në prill të këtij viti vendimi për liberalizimin e vizave për Kosovën u miratua edhe formalisht nga BE-ja dhe u botua në gazetën zyrtare të Bashkimit Evropian po të njëjtin muaj.

Nga 1 janar i vitit 2024 qytetarët e Kosovës pritet të udhëtojnë pa viza në 27 vende të BE-së, të cilat e përbëjnë të ashtuquajturën zonë Shengen.

Për ta pezulluar këtë vendim duhet të merret një vendim tjetër nga Këshilli i BE-së. Kjo mund të bëhet me kërkesë ose nga Komisioni Evropian ose nga ndonjë shtet anëtar. Pastaj, vendet anëtare të Këshillit mund të votojnë për pezullimin e mundshëm.

Janë katër skenarë kur mekanizmi i pezullimit të vizave do të aktivizohet

1. Në rast të rritjes së konsiderueshme - mbi 50 % - të migrimit të parregullt.

2. Në rast të rritjes së konsiderueshme - mbi 50 % - të kërkesave për azil me shkallë të ulët pranimit, rreth 3-4%.

3. Në rast të rënies së bashkëpunimit për riatdhesimin e shtetasve që përjashtohen nga BE-ja, si rezultat i qëndrimit të parregullt.

4. Në rast të rrezikut të shtuar për sigurinë e shteteve anëtare të BE-së, veçanërisht për vepra penale të rënda.

Deri më tash vetëm një herë kishte ndodhur që një shtet anëtar i BE-së ta kërkojë pezullimin e liberalizimit të vizave për një vend të rajonit.

Më 2019 Holanda kishte kërkuar të pezullohej liberalizimi i vizave për shtetasit e Republikës së

Shqipërisë. Si arsyetim e kishte përmendur rrezikun që shtetasit e Shqipërisë të përfshirë në krim të organizuar në Holandë paraqesin për sigurinë kombëtare të këtij vendi. Por, Komisioni Evropian e kishte hedhur poshtë këtë kërkesë.

'Ka zero mundësi që Franca krye në vete ta pezullojë liberalizimin e vizave'

Drejtori i Institutit EPIK, Demush Shasha, ka thënë se Kosova ka kryer të gjitha detyrat e veta të shtëpisë dhe mund të rrijë komode për liberalizimin e vizave. "Ne veç jena tu e prit të buzëqeshur 1 janarin 2024. Eh tash nëse presidenti Macron ka një qëndrim të ri lidhur me liberalizimin e vizave është mirë të sqarohet. Sot ai vetëm ka konfuzuar me deklaratën e tij. Ka zero mundësi që Franca në mënyrë unilaterale dhe krye në

vete ta pezullojë liberalizimin e vizave. Kjo është ligjërishit e pamundshme. Kam thënë edhe më herët. Për mua rregulli i artë sa i përket pezullimit të liberalizimit të vizave është ky: mos merrni seriozisht asgjë derisa nuk dëgjoni Komisionin Evropian duke folur për të. Deri atëherë çdo gjë që dëgjoni është pjesë normale e lojërave dhe negociatave politike", ka thënë Shasha.

Ai ka theksuar se Franca është vend mik dhe aleat i madh i Kosovës. "Franca ka qenë vendi i parë i BE-së që e ka njohur pavarësinë e Kosovës. Menjëherë pas ShBA-së. Që nga dita e parë e shtetit tonë Franca ka qenë me ne në kohët e mira dhe kohët e këqija. Liderhipi i Francës çdoherë ka qenë thelbësor në lartësimin ndërkombëtar të vendit tonë. Patjetër se do të ketë momente kur nuk do të dakordohemi plotësisht me Francën, por çdoherë do të ketë shumë më shumë gjëra që na bashkojnë se ato që na ndajnë", ka deklaruar Shasha.



Mosdekretimi i kryeprokurorit nga presidentja, BE-ja: Nevojë urgjente që procesi i përzgjedhjes të jetë i bazuar në merita

PRISHTINË, 18 TETOR - Ambasadori i Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog, ka reaguar pasi presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, njoftoi një ditë më parë se nuk do ta dekretojë Blerim Isufajn për Kryeprokuror të Shtetit. Në një konferencë për medie, Osmani ka thënë se ka pasur "10 shkelje në procedurën e përzgjedhjes" dhe se "është e obliguar, duke pasur parasysh shkeljet, të mos e bëjë dekretimin" e Isufajt për kryeprokuror. E duke marrë parasysh këtë

deklaratë të Osmanit, ambasadori i BE-së ka theksuar nevojën urgjente që procesi i përzgjedhjes të jetë i bazuar në merita dhe transparencë. "Duke marrë parasysh deklaratën e presidentes për Kryeprokurorin e Shtetit, theksoj nevojën urgjente për një proces përzgjedhjeje të drejtë, të bazuar në merita, transparencë për pozitat brenda sistemit të drejtësisë", ka shkruar Szunyog në rrjetin social "X". Ai u ka bërë thirrje autoriteteve të Kosovës që t'i ruajnë me vendosmëri parimet dhe

standardet më të larta të sundimit të ligjit për zgjedhjen e vonuar të Kryeprokurorit të Shtetit.

Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi ka shkruar në "Facebook" se vendimi i Osmanit është në linjë me qëndrimet e shprehura nga organizatat joqeveritare, ambasadat, Zyra e Bashkimit Evropian në Prishtinë dhe Komisioni Evropian. "Këshilli Prokurorial ka dështuar të udhëheqë një proces të bazuar në meritokraci dhe integritet", ka shkruar Miftaraj.





Shorti i fatit, qytetarët e Kosovës ëndërrojnë për viza pune në Gjermani

Gjatë vitit 2022 Ambasada e Gjermanisë në Kosovë ka lëshuar mbi 9 300 viza pune për shtetasit e Kosovës. Po gjatë 2022-s Kosova ishte vendi i tretë nga Ballkani Perëndimor me më së shumti banorë që morën viza pune për në Gjermani. Për emigracion të fëmijëve dhe bashkim familjar, Kosova radhitej e para. Në vitet e fundit mijëra qytetarë të Kosovës kanë marrë viza pune për në Gjermani. Vetëm vitin e kaluar numri i vizave të punës të lëshuara nga Ambasada e Gjermanisë është rritur për 110 për qind në krahasim me vitin paraprak

PRISHTINË, 18 TETOR - Fillimi i çdo muaji e gjen një 26-vjeçar nga Suhareka në uebfaqen e Ambasadës së Gjermanisë duke aplikuar për vizë pune. Këtë procedurë ai e ka ndjekur që 20 muaj, por... pa fat. "Jo vetëm që bëhet bajat, por nganjëherë edhe harroj të aplikoj [ditën e parë]. Pastaj, të bëhet rutinë. Janë datat e caktuara kur duhet të aplikosh dhe e kryen", thotë ai.

Dikur në dy javët e para të çdo muaji - sa është thirrja e hapur për aplikim - ai thotë se i dedikon rreth 15 minuta kohë për ta kryer aplikimin.

Ai nuk dëshiron të identifikohet me emër, pasi që është i punësuar në Kosovë, por thotë se edhe pse 20 aplikimet e deritanishme nuk kanë pasur sukses, ai do të vazhdojë të aplikojë. "Nuk të

dekurajon [mungesa e suksesit në aplikim] sepse... thjesht e provon fatin", shprehet ai.

Që nga janari i vitit 2021, banorët e Kosovës - bashkë me fqinjët e tyre në Ballkanin Perëndimor - fituan "qasje të privileguar në tregun gjerman të punës", siç thuhet në uebfaqen e Ambasadës së Gjermanisë, pasi që në Gjermani ka hyrë në fuqi "Rregullorja për Ballkanin Perëndimor", përmes së cilës, qytetarët e vendeve të këtij rajoni mund të aplikojnë për vizë pune pavarësisht prej kualifikimit të tyre profesional.

Fillimisht, terminet për vizë pune i fitonte kushdo që arrinte të regjistrohej i pari, por më vonë mënyra e përcaktimit të terminëve ndryshoi, duke u bërë përmes tërheqjes së shortit në

Ministrinë e Jashtme Federale të Gjermanisë në Berlin.

"Radio Evropa e Lirë" pyeti në Ambasadën e Gjermanisë në Prishtinë se sa është numri i kërkesave që parashtrihen për të rezervuar termin për vizë pune brenda muajit, por iu tha se statistika të tilla nuk mbahen. Megjithatë, siç merr vesh REL-i, brenda vitit në dispozicion janë 5 500 vende.

Në uebfaqen e Ambasadës së Gjermanisë në Prishtinë thuhet se mënyra e përcaktimit të terminëve u zëvendësua me procedurën e tërheqjes së shortit "për shkak të kërkesës tejet të lartë për caktim të terminëve, e cila i tejkalon dukshëm terminet që janë në dispozicion".

E përderisa djaloshi nga Suhareka thotë se është i rrethuar nga

shumë shokë e shoqe që kanë kaluar nëpër faza të ngjashme si ai, disa të tjerë kanë pasur më shumë fat në tërheqjen e shortit.

Në vitet e fundit mijëra qytetarë të Kosovës kanë marrë viza pune për në Gjermani. Vetëm vitin e kaluar numri i vizave të punës të lëshuara nga Ambasada e Gjermanisë është rritur për 110 për qind në krahasim me vitin paraprak. Sipas të dhënave, mbi 21 mijë viza pune për Gjermani janë veç për katër vjet.

Një prej përfutuesve të vizës së punës në Gjermani është edhe Ramiz Hoxha, i lindur në fshatin Shalë të Lipjanit. Që gjashtë vjet ai jeton në Hajllbron të Gjermanisë. Për të, procesi i marrjes së vizës nuk ka qenë aq i vështirë. "Për ta marrë vizën, për krejt procedurën kam pritur tre muaj, se atëherë kanë qenë më pak aplikime", thotë Hoxha për "Radion Evropa e Lirë". Ai thotë se përreth tij ka shumë shqiptarë të tjerë. Këtë e tregojnë edhe shifrat e qytetarëve të Kosovës që kanë hequr dorë nga pasaporta e Kosovës për ta marrë atë të Gjermanisë.

Gjatë periudhës janar-qershor të këtij viti, Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës raportoi për rreth 1 500 persona të tillë.

Gjatë periudhës janar-qershor të vitit 2023, mbi 1 500 persona kanë hequr dorë nga pasaporta e Kosovës. Shumica prej tyre e kanë bërë këtë për të marrë nënshtetësi gjermane.

Ndër vite, Gjermania ka qenë vendi për të cilin më së shumti qytetarë të Kosovës kanë hequr dorë nga pasaporta e vendit.

Paga mesatare në Kosovë është 520 euro, ndërsa në Gjermani ishte 4 105 euro, sipas shifrave zyrtare të publikuara në prill të vitit të kaluar. Por, përveç kushteve më të mira të jetesës dhe pagave më të larta sesa në Kosovë, Lirim Krasniqi nga organizata "Germin", e cila merret kryesisht me çështje të diasporës, beson se Gjermania është bërë vend atraktiv për qytetarët e Kosovës edhe për një arsye tjetër. "Arsyeja pse njerëzit shkojnë në Gjermani e jo në Francë dhe vendet e tjera të zhvilluara të Bashkimit Evropian, është sepse Gjermania e ka bërë shumë të lehtë emigrimin prej vendeve të Ballkanit Perëndimor", thotë Krasniqi për "Radion Evropa e Lirë".

Ai thotë se lehtësimi që është bërë përmes "Rregullores për Ballkanin Perëndimor" ka ardhur shkaku i nevojës së Gjermanisë për fuqi

BEI Globale do ta rrisë mbështetjen për tranzicionin e gjelbër, digjitalizimin dhe lidhjen në Ballkanin Perëndimor

PRISHTINË, 18 TETOR - Në samitin e liderëve të procesit të Berlinit të organizuar në Tiranë, zëvendës-presidentja e BEI-t, Teresa Czerwinska, përsëriti angazhimin e bankës për konektivitet më të gjerë, tranzicionin e gjelbër dhe digjital, si dhe sisteme më të forta arsimore dhe shëndetësore.

Si një kontribuues kryesor në planin ekonomik dhe të investimeve të BE-së për Ballkanin Perëndimor, BEI Globale do ta mbështesë planin e ri të zhvillimit për Ballkanin Perëndimor, duke shtuar përpjekjet nën iniciativën për tranzicion të drejtë, për ta ndihmuar rajonin të marrë mundësitë që burojnë nga tranzicioni i energjisë. “Ne jemi të përkushtuar si kurrë më parë për ta mbështetur procesin e zgjerimit. Kjo mbështetje kontribuon në një lidhje më të madhe dhe një tranzicion më të butë të gjelbër, duke përfunduar plotësisht nga agjenda digjitale dhe duke forcuar sistemet arsimore dhe shëndetësore. Që nga viti 2009 BEI ka siguruar rreth 11 miliardë euro në financimin e investimeve të sektorit

publik dhe privat në Ballkanin Perëndimor. Ne kemi financuar rrjetet transevropiane të energjisë dhe kemi ofruar financa gjithëpërfshirëse për bizneset e vogla dhe të mesme - investime që lidhin rajonin fizikisht dhe ekonomikisht me Bashkimin Evropian dhe nxisin konvergencën”, ka thënë ajo.

Në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin Evropian dhe partnerë të tjerë nën kornizën e investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF), BEI Globale po ndjek në mënyrë aktive investime të qëndrueshme, duke përfshirë zbatimin e projekteve të energjisë së pastër dhe të rinovueshme në sektorin publik dhe midis NVM-ve. Banka tashmë ka miratuar rreth 700 milionë euro investime në vitin 2023, duke përfshirë një linjë kredie prej 100 milionë eurosh për financimin e projekteve të efikasitetit energjetik dhe të energjisë së rinovueshme nga NVM-të në Maqedoninë e Veriut. Projekte të tilla tregojnë vendosmërinë e saj të palëkundur për ta nxitur rritjen e qëndrueshme

dhe për ta përmirësuar klimën e investimeve në rajon.

“Ne të gjithë biem dakord për nevojën për një qeverisje më të mirë, rregullore më të thjeshta, për ta shfrytëzuar tranzicionin digjital, për ta rritur konkurrencën duke nxitur tregtinë dhe duke rritur rolin e sektorit privat dhe për zbatimin më të shpejtë të energjisë së rinovueshme. Ne e pranojmë plotësisht se këto rekomandime nuk janë të lehta për t'u zbatuar, por ne besojmë se kolektivisht - duke përfshirë procesin e Berlinit - ne mund ta përdorim procesin e anëtarësimit për ta nxitur konvergencën dhe për ta përsheptuar përparimin e rajonit drejt anëtarësimit në BE”, ka shtuar zëvendës-presidentja Czerwinska.

Forcimi i konektivitetit rajonal dhe i marrëdhënieve ekonomike është një element i rëndësishëm i procesit të konvergencës. Në vitin 2023 BEI Globale ka financuar 120 milionë euro në kredi shtesë për ta modernizuar sistemin e transportit urban të Sarajevës dhe për një projekt të rehabilitimit të rrugëve

në Serbi që do ta bëjë rrjetin e transportit më të sigurt dhe më të fortë dhe do ta forcojë rritjen ekonomike.

Nëpërmjet BEI Globale, dega e BEI-t për aktivitete jashtë Bashkimit Evropian, banka synon të vazhdojë ta mbështesë modernizimin e infrastrukturës kyçe të lidhjes së qëndrueshme në të gjithë rajonin. Kjo përfshin zgjerimin e rrjetit hekurudhor në Shqipëri drejt Malit të Zi, Korridorin VIII në Maqedoninë e Veriut, seksionet e hekurudhës së Korridorit X në Serbi, si dhe rrugën e Korridorit Vc në Bosnjë-Hercegovinë. Si partner afatgjatë i Ballkanit Perëndimor, BEI ka investuar rreth 11 miliardë euro që nga viti 2009 për infrastrukturën jetike të rajonit, krijimin e vendeve të punës, inovacionin dhe NVM-të.

BEI është institucioni financues afatgjatë i Bashkimit Evropian në pronësi të shteteve të tij anëtare. Ai vë në dispozicion financat afatgjata për investime të shëndosha për t'i ndjekur synimet e politikave të BE-së, duke mbështetur projekte në

katër fusha prioritare: infrastrukturë, inovacion, klimë dhe mjedis dhe NVM-të.

BEI është një nga financuesit kryesorë ndërkombëtarë në Ballkanin Perëndimor. Që nga viti 2009 banka ka financuar projekte në rajon me një vlerë rreth 11 miliardë euro.

Procesi i Berlinit u krijua në vitin 2014 si një platformë për bashkëpunim të nivelit të lartë midis përfaqësuesve të lartë zyrtarë të së Ballkanit Perëndimor dhe kolegëve të tyre në vendet pritëse të procesit të Berlinit. Procesi përfshin gjithashtu institucionet e BE-së, institucionet financiare ndërkombëtare dhe shoqërinë civile, rininë dhe bizneset e rajonit. Procesi i Berlinit u iniciua për ta shfrytëzuar potencialin e rritjes së bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor. Ideja ishte nxitja e projekteve specifike për ta rritur konektivitetin në rajon, si dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe marrëdhëniet ndërpersonale, duke mbështetur në vijim integrimin në BE.



punëtore dhe shkak i plakjes së popullsisë gjermane. “Aspekti procedural dhe burokratik është lehtësuar jashtëzakonisht shumë nga ana e shtetit gjerman, në mënyrë që të tërheqë sa më shumë të rinj, veçanërisht profesionistë, që të shkojnë të integrohen atje dhe të punojnë në Gjermani”, shton Krasniqi. Në gusht të këtij viti kabineti

gjerman i miratoi planet për ta lehtësuar rrugën drejt shtetësisë për emigrantët dhe për të lejuar më shumë njerëz të kenë nënshtetësi të dyfishtë.

Sipas rregullave të reja të propozuara, të cilat ende duhet të miratohen nga parlamenti, natyralizimi në Gjermani do të ishte i mundur pas pesë vjetësh, në vend të tetë vjetëve sa është

tani.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, shumica e emigrantëve nga Kosova gjatë viteve të fundit kanë qenë legalë dhe janë larguar për bashkim familjar, gjetje të vendit të punës apo studime afatgjatë.

Gjithsej, rreth 15 për qind e vizave të lëshuara nga Ambasada e Gjermanisë në Kosovë në vitin

2022 ishin viza pune - pjesa më e madhe ishin viza turistike për udhëtim në vendet e zonës Schengen.

Gjatë vitit 2022 Ambasada e Gjermanisë në Kosovë ka lëshuar mbi 9 300 viza pune për shtetasit e Kosovës.

Gjatë vitit 2022 Kosova ishte vendi i tretë nga Ballkani Perëndimor me më së shumti banorë që

morën viza pune për në Gjermani. Për emigracion të fëmijëve dhe bashkim familjar, Kosova radhitej e para.

Nga 1 janari i vitit 2024 qytetarët e Kosovës do të mund të udhëtojnë pa viza në vendet e zonës Shengen për vizita turistike, çështje familjare ose të ngjashme. Por, kjo leje nuk nënkupton edhe leje pune.

Qeveria fillon procedurat për blerjen e objekteve të Ambasadës së Kosovës në Berlin dhe Uashington

PRISHTINË, 18 TETOR - Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin për fillimin e procedurave për blerjen e objektit për nevoja të Ambasadës së Republikës së Kosovës në Berlin si dhe blerjen e

objektit rezidencial në Uashington. Kështu u bë me dije të mërkurën përmes një njoftimi për media nga zyra e informimit e Qeverisë së Kosovës. "Qeveria e Republikës së Kosovës ka

zhvilluar mbledhje elektronike, në të cilën është miratuar vendimi për fillimin e procedurave për blerjen e objektit për nevoja të Ambasadës së Republikës së Kosovës në Berlin,

Republika Federale e Gjermanisë, si dhe blerjen e objektit rezidencial, në Uashington D. C., në Shtetet e Bashkuara të Amerikës", është theksuar në njoftim.



Kryeprokurori i Shtetit shpreh shqetësim për numrin e vogël të mbrojtësve të viktimave të krimit

PRISHTINË, 18 TETOR - Ushtruesi i detyrës i Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, ka marrë pjesë në Konferencën kushtuar Ditës së BE-së Kundër Trafikimit të Njerëzve dhe lansimit të fushatës Kundër Trafikimit të Njerëzve, të organizuar nga Autoriteti Kombëtar për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit të qenieve njerëzore. Gjatë fjalës së tij para të pranishmëve, Kelmendi ka folur për përkushtimin e institucionit të Prokurorit të Shtetit lidhur me trajtimin e rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore, caktimin e koordinatorëve në secilin prokurori për rastet e trafikimit, pjesëmarrjen e Prokurorit të Shtetit në të gjitha aktivitetet në hartimin e legjislacionit primar dhe

sekondar, si dhe avancimin e bashkëpunimit me të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare. Po ashtu, u.d. Kryeprokurori i Shtetit ka shprehur shqetësimin e tij lidhur me numrin e vogël të mbrojtësve të viktimave të krimit, me ç'rast ka kërkuar nga institucionet kompetente të ndajnë më shumë buxhet për shtimin e numrit të mbrojtësve të viktimave të cilët brenda vitit trajtojnë rreth 3 000 raste të ndryshme të viktimave të krimit. Në Konferencën kushtuar Ditës së BE-së Kundër Trafikimit të Njerëzve, përkatësisht lansimin e fushatës Kundër Trafikimit të Njerëzve kanë marrë pjesë përfaqësues nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare që veprojnë në Republikën e Kosovës.



Vitia takon punëtorët e higjienës në QKUK, i njofton për rritjen e pagave mbi 30 %



PRISHTINË, 18 TETOR - Ministri i Shëndetësisë, Arbën Vitia, ka takuar punëtorët e higjienës në QKUK, e cila aktualisht ka 319 punëtorë që kujdesen për mirëmbajtjen e higjienës brenda këtij institucioni. Ai ka thënë se për shumë vjet ka dëgjuar prej tyre nevojat e vështirësitë, por të mërkurën pati mundësinë t'i njoftojë se në bashkëpunim me Ministrinë e Financave kanë rritur buxhetin në mënyrë që edhe pagat e tyre të rriten. "Rritja është mbi 30 % e pagës aktuale. Pagat duhet të jenë të dinjitetshme aq më shumë për ata që kryejnë shërbime kaq të veshme për shëndetin publik. Punëtorët që kujdesen për

higjienën në QKUK janë në frontin e parë të përpjekjes për ta transformuar nivelin e higjienës në klinika. QKUK ka aktualisht 319 punëtorë që kujdesen për mirëmbajtjen e higjienës brenda QKUK-së. Kështu, bashkë me ta folëm sot se si ne do t'i adresojmë kërkesat e tyre e së bashku të ecim para me planet që QKUK të jetë në tjetër nivel të shërbimeve mbështetëse", ka thënë Vitia. Ai ka bërë me dije se bashkë me drejtorin e ShSKUK-së, Elvir Azizi, diskutuan me punëtorët e higjienës edhe për punët që i presin dhe investimet e mbështetjen që do ta japë Ministria e Shëndetësisë.

Eileen Devitt në krye të USAID-it në Kosovë, ambasadori amerikan i uron mirëseardhje

PRISHTINË, 18 TETOR - Eileen Devitt ka marrë detyrën e drejtoreshës së misionit të USAID-it në Kosovë, ka bërë me dije ambasadori amerikan Jeffrey Hovenier. Teksa i ka uruar mirëseardhje, Hovenieri ka thënë se përvoja e Devittit do t'i shërbejë shumë ekipit të Ambasadës Amerikane në

Prishtinë. "Kam kënaqësinë të mirëpres anëtarin e fundit të lartë në ekipin tonë në Kosovë. Eileen Devitt na bashkohet si drejtoreshë e misionit të USAID-it në Kosovë. Udhëheqja dhe përvoja e Eileen do të na shërbejnë shumë pasi USAID-i vazhdon ta avancojë zhvillimin e

Kosovës", ka shkruar ambasadori në rrjetin social "X". Në emër të popullit amerikan, USAID-i promovon dhe demonstroi vlera demokratike jashtë vendit si dhe avancoi një botë të lirë, paqësore dhe të prosperueshme.



Familjes së Afrim Bunjakut i dhurohet donacion në vlerë 9 200 dollarë

PRISHTINË, 18 TETOR - Sindikata e Policisë së Kosovës ka njoftuar se ka vizituar familjen e rreshterit Afrim Bunjaku i cili është vrarë në sulmin e 24 shtatorit në Banjskë. Së bashku me sindikalistët kanë qenë edhe përfaqësuesit e Drejtorisë

Rajonale të Policisë në Pejë dhe përfaqësuesit e Fondacionit "Plavë - Guci" me seli në Amerikë. Bëhet me dije se familjes i është dhuruar donacion në vlerë prej 9 200 dollarësh. "Me datë 17.10.20203 ishim për vizitë te familja e heroit Afrim

Bunjaku së bashku me përfaqësuesit e DRP Pejë dhe përfaqësuesit e Fondacionit 'Plavë - Guci' me seli në Amerikë, ku iu dhurua një donacion familjes së rreshterit Afrim Bunjaku në vlerë prej 9 mijë e 200 dollarësh", thuhet në njoftimin për medie.



Kurti kërkon që forcat shtesë të KFOR-it ta ruajnë kufirin me Serbinë

PRISHTINË, 18 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur në takim komandantin e KFOR-it, gjeneralin Ozkan Ultutas, për të biseduar për situatën e sigurisë në vend.

Kryeministri Kurti ka theksuar që është i interesuar për bashkëpunim të fortë, takime të shpeshta dhe komunikim të rregullt me komandantin e KFOR-it.

Temë qendrore e takimit ishte situata e sigurisë pas sulmit terrorist të 24 shtatorit në Kosovë.

Kryeministri ka theksuar se ky sulm terrorist ka vënë në pah nevojën për rritjen e sigurisë në kufirin në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Sasia e madhe e armatimit dhe municionit ushtarak të konfiskuar është prodhuar në Serbi. Edhe ushtrimet luftarake të paramilitarëve që kryen terror e vrasje në Banjskë të Zveçanit janë kryer në Serbi. Atje Kosova nuk ka juridiksion, prandaj nevojitet edhe një hetim ndërkombëtar në

Serbi mbi përgatitjet, furnizimin dhe orkestrimin e këtij sulmi. Kryeministri e mirëpriti shtimin e numrit të trupave të KFOR-it, në përgjigje të sulmit terrorist nga ana e Serbisë në Kosovë, duke theksuar që kjo prani e shtuar duhet të koncentrohet në ruajtjen e kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë, prej nga edhe ka hyrë armatimi i Serbisë dhe nga vjen kërcënimi për Kosovën", ka njoftuar Qeveria e Kosovës.

Më tej në njoftim theksohet se ruajtja e kufirit nënkupton mbylljen e rrugëve ilegale, prandaj edhe është i domosdoshëm bashkëpunimi më i madh me Policinë e Kosovës. "Kryeministri Kurti, po ashtu, theksoi nevojën që në veri të vendit të ofrohen shërbime të rregullta për qytetarët nga institucionet e Kosovës, prandaj duhet të garantohet liria e lëvizjes", është theksuar në njoftimin e Qeverisë së Kosovës.



Hapet pikëkalimi kufitar në Jarinjë



PRISHTINË, 18 TETOR - Pikëkalimi kufitar në mes të Kosovës dhe Serbisë në Jarinjë është hapur plotësisht për qarkullim mëngjesin e 18 tetorit, gati një muaj pasi ishte mbyllur. Zëvendësudrejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani, ka bërë me dije për medie se kjo pikë kufitare është hapur në orën 08:30 të së mërkurës.

Pikëkalimi kufitar në Jarinjë, por edhe ai në Bërnjak, që gjenden në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe, u mbyllën nga autoritetet e Kosovës më 24 shtator, pas sulmit të armatosur ndaj Policisë së Kosovës, që autoritetet në Prishtinë e cilësojnë si sulm terrorist. Bërnjaku veçse është hapur për hyrje/dalje më 4 tetor, ndërsa Jarinja ka qenë e bllokuar për hyrje në Kosovë, ndërsa ishte e hapur vetëm për dalje.

Autoritetet në Kosovë kanë fajësuar Serbinë për sulmin ndaj Policisë së Kosovës më 24 shtator në Banjskë të

Zveçanit. Në sulmin e një grupi të armatosur serbësh mbeti i vrarë rreshterit Afrim Bunjaku.

Gjatë përlëshjeve mes grupit të armatosur dhe policisë u vranë edhe tre sulmues.

Përgjegjësinë për organizimin dhe udhëheqjen e sulmit e ka marrë Millan Radoičiq, ish-nënkryetar i Listës Serbe, partisë kryesore të serbëve në Kosovë që gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar.

Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë dënuar ashpër sulmin, ndërsa Kosova përmes një rezolute të miratuar në Kuvend ka kërkuar hetim ndërkombëtar për Serbinë lidhur me sulmin në Banjskë.

Kosova ka kërkuar nga Bashkimi Evropian t'i vendosë Serbisë masa ndëshkuese, ndërsa në bllokun evropian kanë thënë se po presin të përfundojnë hetimet dhe më pas do të vendosin për masat dhe hapat eventuale.

Deri më 30 tetor shtyhet seanca ndaj Thaçit dhe të tjerëve

PRISHTINË, 18 TETOR - Seanca e së mërkurës ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit është shtyrë brenda 30 minutave pasi ka filluar. Kjo seancë nga fillimi deri në përfundim ka qenë e mbyllur, ndërsa kryetari i trupit

gjkues, Charles Smith III, deklarantën e vetme që e dha në fund të seancës, ishte se seanca e radhës është më 30 tetor.

Edhe në njoftimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës thuhet se kjo seancë është shtyrë për 30 tetor.

Dëshmitari i 29 ka qenë i caktuar të dëshmojë të mërkurën.

Ky dëshmitar ishte ftuar të dëshmojë në seancën e 11 tetorit. Ai kishte deklaruar se nuk është i gatshëm të dëshmojë, por të shkojë në burg. /Betimi për Drejtësi.



AKB-ja: Ligji për Investime Strategjike të jetë prioritet i qeverisë

PRISHTINË, 18 TETOR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka mbajtur takim të rregullt të Bordit udhëheqës. Në takim u tha se politika investuese në Kosovë duhet të përmirësohet përmes infrastrukturës ligjore për bizneset vendore dhe të huaja në vend. Ligji për Investime Strategjike në Kosovë ishte pika e rëndësishme e

diskutimit, e cila mori vëmendje nga ky bord. U kërkua nga Qeveria e Kosovës që sa më shpejt Ligji për Investime Strategjike të amendamentohet dhe të procedohet në Kuvend të Kosovës për aprovimin me sugjerime dhe vërejtje të komunitetit të biznesit në Kosovë. Ky ligje tash e tri vjet është

pa fuqi juridike dhe pa afate kohore, prandaj Bordi i AKB-së ka kërkuar zgjidhje më të shpejtë që ligji të ketë fuqi për t'i hapur mundësi fuqizimit të investimeve të huaja dhe vendore në Kosovë. Të pranishëm në mbledhje ishin: Agim Shahini, Suat Berisha, Shkëlzen Jusaj, Haziz Tafaj, Gani Ferizi, Ahmet Kuqi e Isak Tusha.



FMN-ja: Zgjedhja e guvernatorit të BQK-së i ka dhënë shtysë të re zbatimit të reformave fiskale dhe financiare në Kosovë

PRISHTINË, 18 TETOR - Një Mision i Fondit Monetar Ndërkombëtar, i udhëhequr nga Gabriel Di Bella, ka vizituar Republikën e Kosovës gjatë periudhës 25 shtator - 6 tetor 2023, për diskutime mbi rishikimet e para të Marrëveshjes së kujdesit paraprak Stand-By (SBA) dhe Instrumentit të Reziliencës dhe Qëndrueshmërisë (RSF) që Kosova ka me FMN-në. Ky ekip i FMN-së, pas përfundimit të misionit, konstatoi se zgjedhja e guvernatorit të ri të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) i ka dhënë shtysë zbatimit të reformave fiskale dhe financiare në



vend. "Emërimi i guvernatorit të ri të BQK-së dhe normalizimi i strukturave qeverisëse të BQK-së i ka dhënë shtysë të re zbatimit të reformave. Stafi i FMN-së pret që së shpejti do të miratohet Rregullorja e re e Punës, e cila do t'i qartësojë përgjegjësitë e Bordit Mbikëqyrës të BQK-së në raport me bordin ekzekutiv dhe që Ligji i ri për Bankat të dorëzohet në Kuvend në fillim të vitit 2024", thuhet në njoftimin e FMN-së. Po ashtu, aty pohohet se cilësia dhe likuiditeti i aseteve të BQK-së është ruajtur në përputhje me objektivat e programit të FMN-së. "Balanci

fiskal dhe depozitat e qeverisë në BQK kanë mbetur mjaftueshëm mbi nivelin e tyre sipas programit gjatë 2023 dhe absorbimi i investimeve publike është rritur ndjeshëm në krahasim me vitin 2022. Stafi i FMN-së pret që dy objektivat për fundin e vitit 2023 do të përmbushen. Gjithashtu, cilësia dhe likuiditeti i aseteve të BQK-së është ruajtur në përputhje me objektivat e programit", ka përfunduar FMN-ja. BQK-ja është në proces të zbatimit të masave të parapara në program, ndërsa është e fokusuar në finalizimin e tyre brenda afateve.

Kosova forcon bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar me Emiratet e Bashkuara Arabe



PRISHTINË, 18 TETOR - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, gjatë qëndrimit të saj në Emirate të Bashkuara Arabe, në shoqërim të ambasadorit tonë Xhabir Hamiti, është pritur në takim bilateral nga ministri i Shtetit të EBA-s, Sh.T. Ahmed Ali Al Sayegh, me të cilin kanë nënshkruar Protokollin e Parë të Komitetit të Përbashkët Ekonomik. Ky protokoll, i cili rrjedh në kuadër të Marrëveshjes për bashkëpunim ekonomik në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe (EBA), forcon bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar mes dy vendeve, duke pasur për qëllim rritjen e tregtisë dhe tërheqjen e investimeve.

Përmes këtij protokoll, Republika e Kosovës dhe Emiratet e Bashkuara Arabe zotohen për ta rritur bashkëpunimin në fusha me interes të përbashkët, ku përfshihen: industria prodhuese, bujqësia, inovacioni dhe teknologjia e mençur, infrastruktura, energjia dhe turizmi. Ndër të tjera, nënshkrimi i këtij protokoll nga ministria Hajdari i hap rrugën Republikës së Kosovës për të tërhequr investitorë të rinj strategjikë nga Emiratet e Bashkuara Arabe. Ministria Hajdari theksoi se Kosova mbetet e hapur për investime të qëndrueshme nga ky vend, derisa ftoi ministrin e Shtetit, Sh. T. Ahmed Ali Al Sayegh, për vizitë në Republikën e Kosovës, për t'i parë nga afër mundësitë e shumta që ofrohen për investimet e huaja.

Hapet edicioni i 23-të i panairit AGROKOS

PRISHTINË, 18 TETOR - Me datat 19 dhe 20 tetor hapet edicioni i 23-të i panairit ndërkombëtar AGROKOS që mbulon sektorin e agrobiznesit, ushqimit dhe pijeve. Ky panair do të hapet në Sallën 1 Tetori në Prishtinë, nga ora 10:00 deri në orën 18:00. Në edicionin e 23-të të panairit AGROKOS do të

marrin pjesë 130 kompani prodhuese, vendore dhe ndërkombëtare. Në mesin e 130 bizneseve ekspozuese, pjesëmarrës janë edhe pesë komuna të regjioneve të ndryshme të Kosovës si: komuna e Pejës, e Gjilanit, e Malishevës, e Kamenicës dhe e Dragashit. Secila prej komunave në panair promovojnë regjionin e

tyre me më së paku pesë biznese, ku në fokus e kanë shtrirjen e produkteve të tyre në gjithë tregun e vendit dhe ftojnë vizitorët t'i shijojnë ushqimet unike nga regjioni i Dukagjinit, Anamoravës, Sharrit dhe rrafshit të Kosovës. AGROKOS është ngjarja e vetme ndërkombëtare e këtij lloji në Kosovë dhe organizohet nga CEO - Congress and Event



Organization, e cila është kompania e vetme e specializuar dhe e certifikuar për organizimin e panairove

dhe ngjarjeve biznesore, kompani e themeluar në vitin 2000 me zyrë në Kosovë dhe në Gjermani.

Toka e plagosur



Djaloshi blond me një bluzë jeshile, qëndron i frikësuar mes bashkëmoshatarëve të tij. E shtynjë dhe e godasin me shkopinj të gjatë, të ndrojtur, sikur sapo t'i kenë urdhëruar. Sa vjeç mund të jenë këta fëmijë? Shtatë? Ndoshta tetë, maksimumi nëntë.

Video tregon një djalë izraelit që mbahet peng dhe ngacmohet nga djem palestinezë të së njëjtës moshë. Ajo qarkulloi në internet të dielën pas sulmit të Hamasit ndaj Izraelit.

Ishte dita e parë e luftës së re. Mizoria e pamjete është e vështirë për t'u kuptuar, edhe sepse është kaq e përmbledhur: fëmijët tashmë po vuajnë, fëmijët po torturojnë njëri-tjetrin, duke e parë njëri-tjetrin vetëm si armik të vdekshëm.

Video pak sekondëshe tregon tragjedinë e këtij konflikti mes dy popujve, mes izraelitëve dhe palestinezëve. Një konflikt që ka zgjatur me dekada, ndoshta një shekull. Dhe në të cilin, porosia si të urresh, torturosh dhe

vrasësh transmetohet nga një brez në tjetrin.

Ky konflikt është si një plagë që nuk shërohet kurrë. Korja është gjithmonë e freskët dhe herë pas here çahet. Dhe pastaj ka luftë.

Por ajo që Izraeli pësoi më 7 tetor 2023 nuk ka ndodhur kurrë më parë në historinë e tij: një sulm terrorist nga Gaza që vështirë se mund të imagjinohej deri atëherë. Më shumë se 1500 terroristë të Hamasit çanë barrierat rreth Rripit të Gazës, pushtuan bazat ushtarake, qytetet, një festival muzikor dhe shkaktuan një gjakderdhje në tokën izraelite.

Ata masakruan gra, fëmijë, foshnja dhe pleq në kibucet përreth dhe në fshatra, vepruan në stilin e terroristëve të "Shtetit Islamik", duke ekzekutuar njerëz në rrugë dhe në shtëpitë e tyre – dhe duke rrëmbyer të paktën 150 pengje. Për më tepër, mijëra raketa fluturuan nga pozicionet në lagjet e varfra drejt qyteteve të Izraelit, aq shumë sa ndonjëherë e mbizotëruan sistemin e

mbrojtjes Iron Dome. Terroristët përdorën dronë komercialë për të hedhur ngarkesa shpërthyes në kullat e sigurisë dhe radiot përreth Gazës; kështu bllokuan me sinjalet. Asnjë alarm nuk ka mbërritur tek ushtarët në dhomat e kontrollit përtej kufirit. Qindra burra të armatosur hynë në Izrael përmes të çarave në gardhin kufitar, në këmbë dhe me motoçikleta. Buldozerët hapën rrugën për automjetet më të mëdha si xhipat.

Një pushtim si një film horror, edhe për Izraelin, i cili është i njohur me operacionet luftarake dhe gjakderdhjen. Vrasësit vijnë me motoçikleta dhe skafe, fluturojnë me parashuta dhe mbajnë veshje luftarake. Asgjë nuk mund t'i ndalojë, është urrejtja ajo që i shtyn.

Për një kohë të gjatë askush nuk e kuptoi shtrirjen e plotë të sulmit dhe për momentin nuk pati asnjë reagim të koordinuar. Më pas, njësitë e ushtrisë u desh të çlironin individualisht të

gjitha vendet e sulmuara nga Hamasi.

1300 të vdekur nga pala izraelite në ditët e para të kësaj lufte, shumica prej tyre civilë, më shumë se 3000 të plagosur dhe shifra mund të rritet. Presidenti izraelit Isaac Herzog thotë se kurrë, që nga Holokausti, nuk janë vrarë kaq shumë hebrenj brenda një dite.

Kaq mizor, aq brutal ishte ky sulm sa duhet të kthehesh gjysmë shekulli prapa, në të ashtuquajturën Lufta e Yom Kipur në vitin 1973, për të gjetur një ngjarje të krahasueshme. Në atë kohë, Izraeli u sulmua nga Siria dhe Egjipti, dhe më 7 tetor 2023 nga qindra militantë të dhunshëm nga Rripi i rrethuar i Gazës.

Plaga po rrjedh gjak përsëri. E freskët. Dhe dhimbja ndjehet kudo.

Presidenti i SHBA Joe Biden dënoi mizorinë e Hamasit si "të keqe të pastër" dhe një "shkelje të çdo kodi të moralit njerëzor". Pati shprehje spontane

solidariteti për viktimat izraelite dhe minuta heshtje. Kulla Eifel dhe Porta e Brandenburgut u veshën në blu dhe të bardhë, ngjyrat e flamurit izraelit.

Por ka edhe ndryshe: festime gëzimi në rrugë në Kajro, edhe në Berlin-Neukölln.

Demonstrata solidariteti për popullin e Gazës në Jemen. Në Doha, kryeqyteti i Emiratit të Katarit, Muzeu Kombëtar është i ndriçuar me ngjyrat kombëtare palestineze.

Konflikti në Lindjen e Mesme e ndan botën në kampe, siç ka bërë gjithmonë.

Atë të shtunë, e cila tani krahasohet me momente kthesash historike, si Pearl Harbor i Izraelit ose 11 shtatori i Izraelit, konflikti izraelito-paltestinez shpërtheu si një bombë thërrmuese para syve të pjesës tjetër të botës. Përsëri. Tani lufta po shkon në Gaza – dhe mund t'i vërë flakën gjithë Lindjes së Mesme.

Të hënën në mbrëmje, ministri i Mbrojtjes Yoav Gallant njoftoi

një bllokadë totale të Rripit të Gazës: “S’ka ushqim, s’ka ujë, s’ka karburant”.

Natyrë e sulmit ndaj shtetit hebre është e re, por logjika dhe konflikti janë të vjetra. Dy popuj pretendojnë të njëjtën tokë. Dhe që atëherë: luftë, dhimbje, rrënim.

Në ditën e pestë pas katastrofës, Noa Kan shikon mbi Detin e Vdekur dhe Shkretëtirën e Judesë. Zëri i saj tingëllon i tendosur: “Pse ne jemi këtu në këtë vend të mrekullueshëm dhe kaq shumë të tjerë kanë vdekur?” Kan dhe i fejuari i saj Yoav i mbijetuan i masakrës në Kibbutzin e Beeri. Thuhet se 110 persona janë vrarë vetëm aty, nga banditët e Hamasit. Terroristët kryen masakra në të paktën shtatë kibbutze përreth Rripit të Gazës; ata vranë prindër, gjyshe dhe foshnja.

Çifti u fsheh në strehën e shtëpisë së tyre për dymbëdhjetë orë para se të dilnin. Ndërsa prisnin, frika e të tjerëve, fqinjëve dhe miqve, depërtonte në muret e trasha të bunkerit. Grupi i chat-it të banorëve të Beerit është një rrëfim tmerri: “Terroristët po hyjnë.” – “Po na qëllojnë.” – “Po na djegin në shtëpinë tonë.” – “Na kanë marrë vajzën.”

Noa Kan është 30 vjeçe. Në prag të masakrës, pati një festë të madhe për të shënuar 77 vjetorin e kibbutzit: “Njerëzit ishin shumë të lumtur”, thotë ajo. Tani shumë nga miqtë dhe fqinjët e tyre kanë vdekur.

Ajo sapo ka marrë lajmin se ka vdekur edhe babai i të fejuarit. Ajo nuk e di nëse terroristët e qëlluan menjëherë apo e torturuan paraprakisht.

Të mbijetuarit janë akomoduar në Kibbutzin Ein Gedi, në Detin e Vdekur, ku ka një hotel elegant me një kopsht botanik, pishinë dhe trajtime spa, ku për ta po kujdesen psikologë dhe punonjës socialë.

Kan e konsideronte veten politikisht më të majtë. Deri tani. Që kur pa fotot nga Gaza, ku njerëzit në rrugë po festonin sulmin terrorist dhe izraelitët e vdekur, kjo ka ndryshuar. “Uroj



që Gaza të mos ekzistojë më.”

“Shpresoj që vendi ynë të bashkohet sërish, të kemi një qeveri të re që përfaqëson unitetin tonë”, thotë Kan. Ajo thotë se kryeministri Benjamin Netanyahu dhe njerëzit e tij e çuan Izraelin në këtë fatkeqësi.

Tre ditë pas sulmit, zona përgjatë barrierës midis Izraelit dhe Gazës i ngjante një hapësire ndërmjetëse të çuditshme. Në një rrethrotullim në qytetin e Sderotit, mizat gumëzhinin mbi gjakun e tharë pranë një minibusi, ndërsa, siç ndodh shpesh, binte alarmi. Zeva Adom. Zeva Adom. Alarmi i kuq. Sderoti është i njohur në të gjithë vendin për shkak të granatimeve të shpeshta nga Rripi fqinj i Gazës.

Disa sekonda më vonë, raketat fërshëlajnë në ajër. Sistemi i mbrojtjes Iron Dome i godet dhe shpërthen që në qiell.

Në një rrugë hyrëse më në jug ka dhjetëra makina të djegura, shoferët dhe pasagjerët e të cilave ndoshta janë vrarë nga terroristët. Pak kilometra më tutje, makinat e shkatërruara po tërhiqen nga burra me jelekë vezullues; pronarët, nëse janë ende gjallë, njoftohen menjëherë me telefon se ku ndodhen makinat e tyre. Të paktën pak rregull në shkatërrim.

Më tutje, drejt bregut, ka tym të zi në qiell: Gaza. Lufta e Izraelit

kundër Hamasit ka filluar. Por ky është vetëm fillimi.

Avionët luftarakë F-16 gjëmojnë në ajër, mund të dëgjosh edhe zhurmën e helikopterëve Apache, shpërthimet, kërcitjen shurdhuese të artilerisë. Tani ka më shumë bombardime sesa në luftërat e mëparshme të Gazës, strategjia dhe qëllimi i Izraelit nuk dihen ende.

Kryeministri Netanyahu ka shpallur “hakmarrje të jashtëzakonshme”. Izraeli ndërmerr një kundërsulm ushtarak dhe mbrohet. Pyetja e vetme është se sa e madhe do të jetë lufta: A do të ketë një ofensivë tokësore të shoqëruar me sulme ajrore? Mbyllja dhe granatimi i bregut nga marina si në 2014?

Apo duhet të shkatërrohet plotësisht Hamasi dhe brezi bregdetar të pushtohet sërish nga ushtria izraelite, siç ishte deri në tërheqjen në vitin 2005? Dhe a është e mundur kjo?

Deri të enjten, ditën e gjashtë të luftës, më shumë se 1,400 palestinezë kishin vdekur dhe më shumë se 6,000 ishin plagosur në sulmet ajrore. Hamasi vepron mes civilëve në qytetet e ndërtuara dendur. Si mund ta dallojë ushtria izraelite popullsinë civile nga Hamasi dhe pasuesit e tij? Ekstremistët shpesh përdorin civilët si mburoja. Një çerek milion njerëz janë në arrati brenda Rripit të

Gazës. Por ata nuk kanë ku të shkojnë.

Edhe në kohë më paqësore, banorët e Gazës nuk mund të largohen nga mjerimi. Edhe në kohë më paqësore, Izraeli dhe Egjipti bllokojnë pikat kufitare. Rripi i ngushtë me më shumë se dy milionë banorë është i rrethuar.

Pak kilometra nga Rripi i Gazës, në Netivot, një tank izraelit Merkava futet në pozicion. Ekuipazhi ndalon automjetin mes një reje pluhuri. Ata nuk e dinë se çfarë do të ndodhë, thotë një nga tre ushtarët pasi futet brenda në çatinë e tankut. Ata vijnë nga Tel Avivi dhe janë mobilizuar tre ditë më parë. Nuk duan të zbulojnë asgjë më shumë.

Asnjë ushtar që takon këtu në zonën e fatkeqësisë nuk flet për atë që do të ndodhë më pas.

Në një pikë karburanti jo shumë larg nga Re'im, ku komandot e Hamasit vranë qindra pjesëmarrës të festivalit të së shtunës, ka erë viçi të skuqur. Vullnetarët përgatisin hamburgera kosher dhe ofrojnë ujë të ftohtë dhe pije freskuese. Një ushtar ndoshta 20-vjeçar me vetulla të pluhurosura mermërit për “betejat e vështira” në të cilat ka marrë pjesë. Ai i përket Brigadës Golan, një njësi këmbësorie e ushtrisë. “Shumë nga miqtë e mi kanë vdekur,” thotë dhe largohet.


Ekziston një paralele tjetër me Yom Kippur 1973: Pas një Luftë Gjashtë-ditore të fituar triumfalisht në 1967, me pushtimet tokësore, Izraeli u ndje i pamposhtur.

E njëjta gjë ishte e vërtetë, në një farë mënyre, deri në atë të shtunë të zezë. Njerëzit në Jeruzalem mendonin se ishin shumë të sigurt, se kishin gjithçka nën kontroll, përfshirë çështjen palestineze. Vitet e fundit është folur shumë për një Lindje të Mesme të re: Izraeli firmosi marrëveshje diplomatike me disa shtete arabe, me Emiratet e Bashkuara Arabe, me Bahreinin, me Marokun dhe Sudanin. Pritej madje një marrëveshje me Arabinë Saudite. Ideja gjeopolitike ishte: Izraeli dhe kombet arabe bashkohen kundër armikut të përbashkët, Iranit. Palestinezët dhe pretendimi për shtetin e tyre nuk luajtën pothuajse asnjë rol: të mbyllur pas gardheve, mureve, barrierave, në Rripin e Gazës, por edhe në Bregun Perëndimor.

Ky i ashtuquajtur normalizim ndoshta ka marrë fund tani për tani. Në ndryshim nga sundimtarët, solidariteti me palestinezët mbetet i fortë në mesin e popullatës arabe.

Në vend të bashkëpunimit paqësor, tani ekziston frika nga një konflikt. Një luftë midis Gazës dhe Izraelit ka pasur gjithmonë potencialin për t'u përhapur në rajon. Edhe sepse është ende e paqartë se kush tjetër mund të qëndrojë pas saj. A mund të ketë sukses vetëm Hamasi në një sulm të këtyre përmasave? Apo është një nga sponsorët e tyre, përkatësisht Irani, përgjegjës për këtë? Nëse Izraeli tani sulmon Hamasin në Gaza, Hezbollahu në Liban dhe milicite iraniane në Siri mund të kundërpërgjigjen – dhe kjo mund të bëhet një luftë e madhe në Lindjen e Mesme. Si masë paraprake, SHBA ka dërguar një grup aeroplanmbajtësesh në rajon. Në realitet, asnjë nga fuqitë rajonale nuk është e interesuar për një përshkallëzim gjithëpërfshirës. / Me shkurtime nga Der Spiegel – Bota.al





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Xherdan Shaqiri në garë për golin e raundit nga UEFA, rrezikohet nga një serb

PRISHTINË, 18 TETOR - Xherdan Shaqiri ka zhvilluar një nga ndeshjet e tij më të mira me fanellën e Përfaqësueses së Zvicrës në barazimin dramatik 3-3 me Bjellorusinë. Ylli nga Kosova ishte i

pandalshëm në këtë sfidë me një gol të shënuar dhe një asistim fantastik. Megjithatë goli i tij ishte i jashtëzakonshëm dhe është në garë për golin më të mirë të raundit nga UEFA. Shtëpia më e madhe e

futbollit evropian në faqen e saj 'UEFA Euro 2024' ka hapur votimet për tifozët për golin më të mirë të raundit. Shaqiri është në garë me yllin turk Yunus Akgun atë ukrainas Mykhaylo Mudryk si dhe serbin Alaksandar

Mitrovic.

32-vjeçari realizoi një gol spektakolar dhe sigurisht që, përveç votave të zviceranëve, i meriton edhe votat e shqiptarëve për gjithçka që ka bërë rreth reprezentimit të shqiptarëve.



Presidenti i FFK-së priti ekipin e FC Kastrioti Stukenbrock

Para fillimit të ndeshjes së Superkupës Kosovë - Diasporë, presidenti i FFK-së, Agim Ademi, bashkë me nënkryetarin Bakir Burrin, kanë pritur të mërkurën në takim FC Kastrioti Stukenbrock, presidentin e ekipit, trajnerin dhe futbollistët, e ku i pranishëm ishte edhe kryetari i Federatës së Futbollit Shqiptar në Gjermani, Ruzhdi Statovci dhe sekretari Miftar Dragidella.

I pari i FFK-së tha se kupa është simbol i shtetit, prandaj ndeshja e sotme është shumë e rëndësishme. "Kur e dimë se kupa është simbol i shtetit duhet kujdes i veçantë jo vetëm për këtë ndeshje, por për çdo ndeshje tjetër të kupës. Ne e dimë rolin tuaj në Diasporë dhe jemi të lumtur me përkushtimin që kryetarët e klubeve shqiptare kanë në Gjermani dhe japin maksimumin e tyre për t'i mbështetur klubet e tyre. Ne duhet të jemi të bashkuar në çdo pikë dhe në çdo vend. Ju dëshiroj suksese të vazhdueshme dhe ju



premtoj se gjithmonë do ta keni përkrahjen time dhe të FFK-së", tha Ademi.

Ndërkaq kryetari i FFSHGj-së, Ruzhdi Statovci, e falënderoi presidentin Ademi për pritjen dhe mbështetjen e rezervë nga shtëpia e futbollit në Kosovë. "Falënderoj presidentin Ademi për gatishmërinë që ka për t'i mbështetur ekipet tona në Gjermani dhe për bashkëpunimin e mirë disaveçar. Po ashtu, vlerësoj kontributin e futbollistëve të këtij klubi, të cilët kanë lindur në Gjermani, por që ndihen të privilegjuar të luajnë për shtëpinë e tyre, FC Kastrioti. Këta futbollistë janë edhe ambasadorë të vendit të tyre dhe përfaqësojnë me krenari vendin e tyre në fushën e futbollit", theksoi ai.

FC Prishtina, fituese e Superkupës Kosovë - Diasporë



PRISHTINË, 18 TETOR - FC Prishtina e ka fituar Superkupën Kosovë - Diasporë pasi ka shënuar fitore kundër FC Kastrioti Stukenbrock, me rezultat 4:0, në ndeshjen e zhvilluar në Kampin Nacional në Hajvali. Para fillimit të ndeshjes presidenti Agim Ademi dhe kryetari i FSHHGj-së, Ruzhdi Statovci, e nderuan me pllakate dhe mirënjohje futbollistët e Kastriotit, Naim Pajazitit, i cili në këtë ndeshje u përshëndet nga futbollit aktiv.

Ashtu siç pritej, bardhekaltrit e



kryeqytetit dominuan në ndeshje, duke sulmuar disa herë portën mysafire, por nuk arritën ta shënojnë në pjesën e parë.

Ndërsa skuadra nga Diaspora dëshmoi organizim të mirë në mbrojtje, madje në disa raste edhe u shfaq kërcënuese para portës së Agron Kolajt. Rezistenca e Kastriotit u thye në minutën e 65-të, kur Diar Halili shënoi për 1:0, teksa në minutat e fundit Prishtina u shfaq edhe më efikase, duke realizuar edhe tre gola të tjerë përmes: Albin Krasniqit (85'),

Hasan Hysenit (88') dhe Jalen Miller Blesas (90').

Duhet theksuar se trajneri i Prishtinës, Debatik Curri, në këtë ndeshje u dha më shumë hapësirë futbollistëve që kanë pasur minuta më të pakta gjatë këtij edicioni në Superligë.

Në fund medaljet për dy ekipet i dhanë nënkryetari Agim Dibrani dhe anëtarja e KE të FFK-së, Vjollca Krasniqi, derisa trofeun e këtij aktivitetit për kapitenin e Prishtinës, Mërgim Pefqeli, e dha presidenti Agim Ademi.

Laporta do të dalë në gjyq për çështjen e ryshfetit në 'rastin Negreira'

BARCELONË, 18 TETOR - Presidentit të Barcelonës, Joan Laporta, i kanë mbetur edhe tre vjet në mandatin e tij, por ka mundësi të përfundojë herët me mjete ligjore. Laporta do të dalë në gjyq së bashku me ish-presidentët Sandro Rosell dhe Josep Maria Bartomeu dhe vetë klubin për pagesat ndaj ish-zëvendës-presidentit të Komitetit të Gjyqtarëve, Jose Maria Enriquez Negreira.

Sipas gazetës "Marca", gjykata që organizon hetimin për pagesat ka vendosur që parashkrimi të

zbatohet nga pagesa e fundit që i është bërë Negreiras. Kjo do të thotë se Laporta është i përfshirë në këtë rast dhe ai tani akuzohet për ryshfet së bashku me ish-kolegët.

Statuti i kufizimeve është vendosur në 10 vjet për krimet e ryshfetit, të cilat datojnë që nga viti 2023 kur u hap çështja, përfshinte presidentët të Barcelonës të përfshirë në pagesën e Negreira midis 2013 dhe 2018 (kur pagesat u ndaluan). Megjithatë, gjykatësi Joaquin Aguirre ka vendosur që statuti i



kufizimeve daton që nga koha kur janë bërë pagesat përfundimtare. Kjo daton në vitin 2008 dhe do të përfshinte Laportan për dy vitet e

fundit të mandatit të tij të parë në Barcelonë, përpara se Roselli ta merrte drejtimin më 2010.

Deri më tani Laporta ka mohuar çdo keqberje nga ana e klubit në lidhje me korrupsionin, duke e quajtur një fushatë kundër Barcelonës. Ata thonë se janë duke bashkëpunuar me prokurorin për këtë çështje.

Asnjë korrupsion sportiv nuk është vërtetuar ende, por akuzat për ryshfet thjesht korrespondon me pagesën e një zyrtari publik për kryerjen e detyrës, pavarësisht nga

reciprocimi i marrë. Barcelona dhe Laporta ka të ngjarë të argumentojnë se Negreira nuk është një zyrtar publik, por pjesë e një kompanie private në RFEF.

Nëse Laporta do të dënohej, ai mund të përballet me burgim nga tre deri në gjashtë vjet. Ndërkohë, klubi mund të përballet me çdo gjë, nga një paralajmërim deri te falimentimi, në varësi të dënimit. Duhet theksuar se në këtë pikë Laporta dhe Barcelona akuzohen për ryshfet si pjesë e çështjes, por ende nuk janë shpallur fajtorë.

Zvicra nderon Blerim Xhemailin për kontributin 12-vjeçar në përfaqësuese

BERN, 18 TETOR - Blerim Xhemaili është pensionuar nga futbollit aktiv në fund të sezonit të kaluar pas një karrierë të shkëlqyer. Ish-mesfushori shqiptar ka bërë një karrierë të gjatë në klube të mëdha si Zurich, Bolton, Torino,

Parma, Napoli, Galatasaray, Genoa, Bologna, Montreal Impact e Shenzen.

Xhemaili i dha fund karrierës së tij aty ku e nisi të FC Zurich, derisa ka dhënë kontribut të madh edhe të Përfaqësuesja e Zvicrës.

37-vjeçari ka luajtur për të gjitha grupmoshat e Zvicrës, derisa tek ajo 'A' ka zhvilluar 69 ndeshje.

Ish-legjenda e Zurichut për 12 vjet sa ishte pjesë e Zvicrës nga 2006 deri më 2018 ka realizuar 10 gola dhe ka asistuar në gjashtë të tjerë.

Në ndeshjen e fundit që Zvicra e zhvilloi ndaj Bjellorusisë, Xhemaili u nderua nga Federata e Futbollit e Zvicrës dhe mori duartrokitje të panumërta nga tifozët për kontributin e dhënë për helvetikët.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 01/2023); lidhur me nenin 27.2 të Rregullores (ZKA) 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2023 si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr. 1866 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit ri shpall:

KONKURS
për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. Pozita:	Auditor junior për auditim financiar dhe pajtueshmëri
Numri i referencës:	AJAFP/ZKA/16-10/23
Grada:	ZKA-A8
Numri i pozitave:	Tre (3)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ndhmon UE në mbledhjen e informatave paraprake për auditimet ku angazhohet, për përgatitjen e dosjeve të auditimit dhe punë tjera në lidhje me auditimin;
- Shkrimi i letrave të punës së auditimit të qarta për çështjet e trajtuara dhe sipas standardeve të ZKA-së dhe të njëjtat i dorëzon me kohë të UE;
- Indeksimi i letrave të punës për temat (mostrat) dhe fushat e audituara dhe të gjitha dokumentet (edhe ato që merren në Entitete) duhet të jenë në pajtueshmëri me formatin dhe kërkesat e përcaktuara nga metodologjia, që t'i mundësojë UE një rishikim me të lehtë;
- Përfundimi me kohë i letrave të punës, memove të komponentëve dhe të gjitha detyrave sipas kërkesave të UE për t'i arritur planet kohore të aprovuar nga menaxhmenti;
- Ofron bashkëpunim dhe informata të sakta për Ekipin e auditimit, departamentin e tij dhe me të gjithë sektorët dhe departamentet e tjerë në kuadër të ZKA-së;
- Ndhmon stafin tjetër të ekipit dhe të departamentit, rreth punëve audituese, për përdorim të teknologjisë informative, ofron përkrahje UE dhe të jetë përgjegjës në ushtrimin e detyrave për realizimin e objektivave të ekipit dhe të departamentit;
- Komunikim të mirë me anëtarët e ekipit me UE, DD, stafin e ZKA dhe me stafin e entiteteve gjatë auditimit;
- Të ruajë dhe azhurnoi njohuritë profesionale dhe teknike dhe të tregojnë gatishmëri për të marrë njohuri të reja nga fusha e auditimit për fushat e dakorduara me UE dhe DD gjatë vlerësimit të performancës për vitin e kaluar, dhe të ndjekë trajnimet e organizuara nga ZKA që lidhen me Edukimin e Vazhdueshëm Profesional;
- Tregojnë integritet të lartë dhe vepron në pajtim me Kodin Etik dhe të Mirësjelljes Profesionale, si brenda ashtu edhe jashtë ZKA-së;
- Kryen edhe detyra tjera profesionale që mund të kërkojnë nga UE dhe DD i/e tij.

Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Tre (3) vite përvojë pune profesionale në auditim, kontabilitet, financa ose administratë publike;
- Certifikatë në njërin nga skemat e certifikimit si teknik kontabiliteti dhe asistent-auditor i sektorit publik.

Shkathësitë e kërkuara:

- Njohuri në fushën e auditimeve;
- Shkathësi në organizim të punës dhe përbushje të objektivave;
- Njohuri të akteve juridike të aplikueshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Njohuri për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi motivuese, dhe komunikuese në ekip;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

Informata të përgjithshme për kandidatë:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- certifikatë për teknik kontabiliteti ose asistent-auditor i sektorit publik;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **03.11.2023 ora 16.00**.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa Članom 15.2 Zakona Br. 05/L-055 o Generalnom revizoru i Nacionalnoj kancelariji revizije Republike Kosovo, kao i Članom 5, 6 i 7 Pravilnika (NKR) 03/2021 o Prijemu i Karijeru u Nacionalnoj kancelariji revizije (izmenjeno i dopunjeno Pravilnikom (NKR) Br. 01/2023), vezano za Član 27.2 Pravilnika (NKR) 02/2021 za kvalifikaciju radnih mesta, godišnjeg plana zapošljavanja za 2023. godinu, kao i Odluci Generalne revizorke sa Br. 1866 datuma o popunjavanju slobodnog radnog mesta, Nacionalna Kancelarija Revizije ponovo objavljuje

KONKURS
za popunjavanje slobodnih radnih mesta

1. Pozicija:	Junior Revizor za finansijsku reviziju i reviziju uskladenosti
Broj reference:	AJAFP/ZKA/16-10/23
Koeficijent:	ZKA-A8
Broj pozicija:	Tri (3)
Trajanje imenovanja:	Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Pomaže Vodju Tima Revizije (VT-u) u prikupljanju preliminarne informacije o revizijama u kojima se angažuje, u pripremi revizorskih dosijea i obavlja druge poslove vezane za reviziju;
- Jasno pisanje u popunjavanju revizorskih radnih dokumenata o adresiranju pitanjima i u skladu sa standardima NKR-a i njihovo blagovremeno dostavljanje VT-u;
- Indeksiranje radnih dokumenata o temama (uzorcima) i revidiranim oblastima i svih dokumenata (uključujući one primljene od subjekata) koje treba da budu u skladu sa formatom i zahtevima navedenim u metodologiji, kako bi se VT-u omogućila lakša revizija;
- Blagovremeno popunjavanje radnih dokumenata, memorandumima o komponentama i svih zadataka u skladu sa zahtevima VT-a da bi se postigli rokovi koje je odobrio menadžment;
- Pruža saradnju i tačne informacije Timu za reviziju, njegovom departmanu i svim drugim sektorima i departmanima u okviru NKR-a;
- Pomaže drugom osoblju tima i departmana, oko revizorskog rada, za korišćenje informacionih tehnologija, pruža podršku VT-u i odgovoran je u sprovođenju zadatka za postizanje objektivna tima i departmana;
- Dobra komunikacija sa članovima tima sa osobljem VT-em, DD-em, NKR-om i osobljem subjekata tokom revizije;
- Održavati i ažurirati stručno i tehničko znanje i pokazati spremnost za sticanje novih znanja iz oblasti revizije za oblasti dogovorene sa VT-em i DD-em tokom procene učinka za prethodnu godinu, kao i za pohađanje obuka koje organizuje NKR u vezi sa kontinuiranim profesionalnim usavršavanjem i obrazovanjem;
- Pokazuje visok integritet i poštuje Kodeks etike i profesionalnog ponašanja, kako unutar tako i van NKR-a;
- Obavlja i druge profesionalne zadatke koje se mogu zahtevati od VT-a i DD-a.

Osnovne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma;
- Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva u reviziji, računovodstvu, finansijama ili javnoj upravi;
- Sertifikat u jednoj od šema sertifikacije kao računovodstveni tehničar i pomoćnik-revizor u javnom sektoru.

Potrebne veštine:

- Poznavanje polja revizije;
- Veštine u organizaciji rada i ispunjavanju ciljeva;
- Poznavanje pravnih akata koji važe za Nacionalnu kancelariju revizije;
- Poznavanje o efektivnom nadzoru profesionalnog rada;
- Veštine da predstavlja i štiti interese institucije i njenog integriteta ;
- Motivacione i komunikativne veštine u timu;
- Dobre međuljudske veštine.

Opšte informacije za kandidate:

Naknada plate za objavljene pozicije vrši se u skladu sa zakonom na snazi.

Procedura apliciranja:

Procedura apliciranja je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i dočekuje kandidate iz svih zajednica na Kosovu

Kandidati trebaju dostaviti sledeća potrebna dokumenta:

- službeni Formular NKR-a za apliciranje;
- kopiju lične karte Republike Kosova;
- dokaze o školskoj spremi (diploma fakulteta), Diplome stečene van Kosova moraju itd nostrifikovane;
- Sertifikat za tehničara računovodstva ili asistent – revizor javnog sektora;
- dokaze o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Potvrda o radnom odnosu sa priloženim dokazima iz Trusta);
- svedočenje iz suda da nije pravosnažno osuđivan (ne starije od šest meseci);
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog službenika (ako je primenljiva);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Formulari za konkurisanje dostavljeni nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpune će biti odbijene. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja na elektronskim medijama (onlajn) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije. Zadnji rok za podnošenje dokumentacije **03.11.2023 godine do 16.00 časova**.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

Beleška:

Aplikacione poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručjenju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 01/2023); lidhur me nenin 14 të Rregullores (ZKA) 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2023 si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr. 1860 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. Pozita:	Udhëheqës i Njësisë së Prokurimit
Numri i referencës:	UNP/ZKA/15-10/23
Grada:	ZKA-C3
Numri i pozitave:	Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Hartimi i Planit vjetor të punës për vitin përkatës për Njësinë e Prokurimit;
- Hartimi i propozim planit vjetor të prokurimit dhe koordinimi i aktiviteteve më njësitë kërkuese për hartimin e planit;
- Menaxhimi i të gjitha aktiviteteve të prokurimit në përputhje me Planin vjetor të prokurimit publik dhe legjislacionin në fuqi;
- Hulumtimi i tregut me qëllim të realizimit të aktiviteteve të prokurimit në mënyrën më efektive dhe ekonomike;
- Monitorimi i zbatimit të kontratave të lidhura dhe nxjerr urdhër-blejës me kohë dhe sipas kushteve të kontratës;
- Përcakton metodologjinë e prokurimit për tender dhe procedurat e vlerësimit të çmimeve dhe ofron këshilla dhe asistencë menaxhmentin në marrjen e vendimeve lidhur me çështjet kontestuese që mund të dalin në rastet e ekzekutimit të kontratave;
- Menaxhon me dosjet e prokurimit, duke përfshirë sistemin, klasifikimin dhe arkivimin e dokumentacionit sipas kërkesave ligjore dhe raporton rregullisht për punët e kryera dhe realizimin e detyrave;
- Bashkëpunimi me organet tjera kompetente për prokurimin publik – AQP dhe KRPP;
- Kryen detyra të tjera të përcaktuara nga Drejtori i Përgjithshëm.

Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale që ndërlidhet me vendin e punës;
- Tre (3) vjet përvojë menaxheriale;
- Të jetë i certifikuar për prokurim publik sipas legjislacionit në fuqi.

Shkathësitë e kërkuara:

- Shkathësi të avansuara në menaxhim, organizim dhe caktim të objektivave;
- Njohuri të shkëlqyeshme për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi udhëheqëse, motivuese dhe komunikuese në menaxhim të performancës;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

Informata të përgjithshme për kandidatët:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- Certifikatë sipas legjislacionit përkatës për prokurimin publik;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **03.11.2023 ora 16.00**.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollëshme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa članom 15.2 Zakona 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalne Kancelarije Revizije Republike Kosova, kao i Člana 5, 6 i 7 Uredbe (NKR) 03/2021 o prijemu i Karijeru u Nacionalnoj Kancelariji Revizije (izmenjeno i dopunjeno u Pravilniku (ZKA) Br. 01/2023); vezano sa Članom 14 Pravilnika (NKR) 02/2021 o Klasifikaciji radnih mesta, Godišnjem planu za regrutaciju za 2023. godine, kao i Odlukom Generalne revizorke br.1860, Nacionalna Kancelarija Revizije objavljuje:

KONKURS za popunjavanje slobodnog radnog mesta

1. Pozicija:	Rukovodioc Jedinice za nabavku
Referentni broj:	UNP/ZKA/15-10/23
Rang:	ZKA-C3
Broj pozicija:	Jedna (1)
Trajanje imenovanja:	Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Izrada godišnjeg plana rada za relevantnu godinu za Jedinicu nabavke;
- Izrada predloga godišnjeg plana nabavki i koordinacija aktivnosti sa zahtevnim jedinicama za izradu plana;
- Upravljanje svim aktivnostima nabavke u skladu sa godišnjim planom javnih nabavki i zakonima na snazi;
- Istraživanje tržišta u cilju obavljanja aktivnosti nabavke na najefikasniji i najekonomičniji način;
- Nadzor realizacije zaključenih ugovora i izdaje naloge za kupovinu na vreme i prema uslovima ugovora;
- Određuje metodologiju tenderske nabavke i procedure procene cena i daje savete i pomaže menadžmentu u donošenju odluka u vezi sa spornim pitanjima koja se mogu pojaviti u slučajevima izvršenja ugovora;
- Upravlja dosijeima nabavke, uključujući sistematizaciju, klasifikaciju i arhiviranje dokumentacije u skladu sa zakonskim zahtevima i redovno izveštava o obavljenom poslu i ispunjavanju zadataka;
- Saradnja sa drugim nadležnim organima za javne nabavke – CAN i RKJN;
- Obavlja i druge poslove koje odredi Generalni direktor.

Osnovne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma;
- Sedam (7) godina profesionalnog radnog iskustva koja se povezuje sa radnim mestom;
- Tri (3) godine rukovodećeg iskustva;
- Da bude sertifikovan za javne nabavke u skladu sa važećom zakonskom regulativom.

Potrebne veštine:

- Napredne veštine u upravljanju, organizaciji i postavljanju ciljeva;
- Odlično poznavanje efektivnog nadzora nad stručnim radom;
- Sposobnost zastupanja i zaštite interesa institucije i njenog integriteta;
- Liderske, motivacione i komunikacione veštine u upravljanju učinkom;
- Da poseduje dobre međuljudske veštine.

Opšte informacije za kandidate:

Određivanje plate vrši se u skladu sa važećim zakonima.

Procedura aplikacije:

Procedura aplikacije je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna kancelarija revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve državljane Kosova i pozdravlja kandidate iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati trebaju predati sledeća potrebna dokumenta:

- službeni formular NKR-a za aplikaciju;
- kopiju lične karte Republike Kosovo;
- dokaz o školskoj spremi (fakultetska diploma). Diplome dobijene van Kosova moraju biti nostrifikovane;
- Sertifikat prema određenom zakonodavstvu za javne nabavke;
- dokaz o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Dokaz o radnom odnosu, uz dokaz iz Penzionog fonda);
- dokaz iz suda da nije pravosnažno osuđivan (ne starije od šest meseci);
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog funkcionera (ako je primenljiva);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Dokumenta dostavljena nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpuna će biti odbijena. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Konkurs je otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja na elektronskim medijama (onlajn) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije. Zadnji rok za podnošenje dokumentacije **03.11.2023. godine do 16.00 časova**.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

Beleška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručenju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.

TC.ZIRAAT BANKASI A.S - DEGA NE KOSOVE		
Bilanci i gjendjes me : 30.09.2023		Euro'000
	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
Pasurite		
Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK-në	8,772	12,535
Kërkesat ndaj bankave	3,451	7,202
Bonot e thesarit	-	-
Investimet në letra me vlerë	3,992	7,019
Kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve	97,989	94,755
Patundshmëritë dhe pajisjet	1,512	2,128
Pasuritë e paprekshme	146	274
Pasuritë tatimore të shtyra	-	-
Pasuritë tjera	106	136
Gjithsej pasuritë	115,967	124,049
Detyrimet		
Depozitat e klientëve	81,731	78,854
Detyrimet ndaj bankave	12,370	23,088
Fondet tjera të huazuara	-	-
Detyrimet tatimore të shtyra	-	-
Detyrimet tjera	1,071	1,205
Gjithsej detyrimet	95,172	103,147
Ekuiteti i aksionarëve		
Kapitali aksionar	20,000	20,000
Rezervat e kapitalit	-	-
Fitimi i mbajtur/(humbja) nga vitet paraprake	220	220
Fitimi/(humbja) e vitit aktual	575	682
Përbërësit tjerë të ekuitetit	-	-
Gjithsej ekuiteti i aksionarëve	20,795	20,902
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti i aksionarëve	115,967	124,049

TC.ZIRAAT BANKASI A.S - DEGA NE KOSOVE		
Pasqyra e të ardhurave për tremujorin që përfundon me: 30.09.2023		Euro'000
	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
Të hyrat nga interesi	3,381	5,088
Shpenzimet e interesit	1,039	1,611
Neto të hyrat nga interesi	2,343	3,477
Të hyrat nga tarifave dhe komisionet	105	155
Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve	108	160
Neto të hyrat nga tarifave dhe komisionet	3	5
Neto të hyrat nga tregtimi	3	7
Neto të hyrat nga instrumentet tjera financiare	0	1
Neto të hyrat (shpenzimet) tjera operative	1,170	1,779
Gjithsej të hyrat	1,174	1,701
Provizionet për humbjet nga kreditë	574	937
Provizionet tjera	55	37
Fitimi/(humbja) para tatimit	654	801
Shpenzimet e tatimit në fitim	79	119
Shpenzimet e tatimit të shtyr	-	-
Fitimi/(humbja) neto	575	682
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	575	682



Gjeje PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi



Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë


www.facebook.com/gjejepuneshpejte

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Adelina Hasiq nga Ulqini "Mahalla e Re" shpall të humbur kartelën e semsi-të, të Universitetit të Prishtinës.
- Fatmir Shkodra shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit Ekonomik Prishtinë.
- Bislim Bislimi shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Fazli Greicevci".
- Ruzhdi Rashiti shpall të pavlefshëm certifikatën e aftësimit profesional me numër protokollit: 5438/19 e lëshuar me 08.10.2019 në Ferizaj, drejtimi: Murator/Ndërtimtar.
- Eslem Gashi shpall të pavlefshme dëftesat, certifikatën, diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.
- Munir Anadolu shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren.
- Nuridin Isljami shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën Q.K."11 Marsi" Prizren.
- Taulant Gashi shpall të pavlefshme 4 dëftesat Q.K "11 Marsi" Prizren.
- Nuh Rexhepi shpall të pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.
- Hami Ramadan Bajraliu shpall të pavlefshme Diplomën e Universitetit të Prishtinës, drejtimi Ekonomik me nr. 742.
- Anita Uka shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore nga kl. parë deri të nëntën të shkollës "Nazim Gafurri" Prishtinë.
- Naser Shunjaku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike "Nexhmedin Nixha".
- D.P.H. "Burimi" shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330286147-Gjilan.
- Bulent Bytyqi shpall të pavlefshme 4 dëftesat shme "Ymer Prizreni" Prizren.
- Fikret Ajazaj shpall të pavlefshme diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren.
- Egzona Rustemi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. dhjetë (X), njëmbëdhjetë (XI) dymbëdhjetë (XII) si dhe Diplomën e Gjinnazit "Naim Frashëri" Shtime.

RESTAURANT



SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156
+386 49 848 553

PRISHTINË

